ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: (**Ministria e Punëve të Brendshme***)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:*(* **214-22-12230-5-5-8-1***)*

Sa i përket tenderit për*(***Furnizim me pajisje te IT-se***)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ARITECH SHPK_____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan, përball QMI _____
(Adresa)

_____Graçanicë_____ _____10500_____
(Vendi)(Kodi postar)

_____+383 38 600 500_____ _____
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

_____Fahri Avdiu_____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____fahri@aritech-ks.com_____
(Adresa elektronike)

_____19.12.2022_____ _____
(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ftesa per oferte eshte derguar permes e-prokurimit me dt. 02.11.2022*, afati i fundit per dorezim te ofertes ka qene me date 08.11.2022 h 13:30.* *Ne kete aktivitet te prokurimit kane marr pjese shtatë ofertues.* *Aritech shpk per nga çmimi eshte tenderuesi me i lire per kete projekt tenderues.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Ne pas njoftimit mbi vendimin e AK-se si dhe letres standarde per tenderuesin e eleminuar perkatesisht te Aritech shpk në afat të rregullt kohorë kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim prane AK-së.

Nga AK fillimisht me date 01.12.2022 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se, perkatesisht vendimin mbi tenderuesin e eleminuar.
Ne baze te saj kemi dorezuar kerkesen per Rishqyrtim prane AK-se me date 06 .12.2022.
AK pasi ka shqyrtuar kërkesën tonë me datë 08.12.2022 ka derguar pergjigje mbi vendimin lidhur me shqyrtimin e kërkesës ku edhe kishte vleresuar kerkesen tone si te pabazuar . Ne nuk kemi qene te kenaqur me vleresimin e tille prandaj duke u bazuar ne LPP paraqesim ankesë në OSHP kundër vendimit të AK-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

Neni 6
Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në

një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne me date 01.12.2022 kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e AK-se si dhe letren standarde per tenderuesin e eleminuar.

Autoriteti Kontraktues ka vendosur te shperbleje me kontrate Botek shpk.

Autoriteti Kontraktues eleminon oferten e Aritech shpk me arsyetimin si ne vijim:

Citojme:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar, sepse gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit Tuaj, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se Ju nuk keni dorëzuar dëshmi si është kërkuar në faqen 7 të Ftesës për Ofertim,

IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara

Tenderi do të përbëhet nga dokumentet e plotësuara dhe të nënshkruara si në vijim:

f. OE duhet te paraqes dëshmi për gjeneratën e procesorit qe duhet te jete minimumi gjeneratë e parafundit nga dita e "Ftesës për Ofertim".

Ju në tenderit tuaj për këtë kërkesë keni dorëzuar dëshmi nga prodhuesi që tregon se pajisjet e ofruara janë gjeneratë e 10 e procesorit.

Katalogët e dorëzuara me ofertë dhe **deklaratën për Specifikimin teknik** i ofertuar për artikullin 1 dhe 4:

Nr. i art.	Përshkrimi	Processor i ofertuar
1.	Brand Name **PC - Model I (i7)** Shtëpiza, Tastaturë, Maus	Core i7-11700F
4.	Brand Name **LAPTOP MODEL III (i5)**	Mini.Core i5-1135G7

janë të gjeneratës se 11-te, kurse është dashtë të ofertoni dhe dorëzoni katalogët të pajisjeve të gjeneratës se 12-të.

Nga hulumtim në internet, komisioni vlerësues ka ardhur në konstatim dhe përfundim se produktet e ofertuar nuk janë te gjeneratës se parafundit nga dita e "**Ftesës për Ofertim**" e datës 02.11.2022.

Që nga data 20.10.2022 në treg është gjenerata e 12 e procesorëve.

Andaj, pasi nuk kemi pranuar ofertë në pajtueshmëri me kërkesat në Ftesën për Ofertim, **tenderi juaj nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.**

Ne arsyetimin me larte ka shume kunderthenie dhe te paverteta.

Aludimi se : *" Ju ne tenderin tuaj per kete kerkese keni dorezuar deshmi nga prodhuesi qe tregon se paisjet e ofertuara jane gjenerata e 10 e procesorit"* eshte i pavertet pasi qe ne nuk kemi ofertuar as nje produkt me cpu te gjenerates 10, po ashtu edhe katalogjet e ofertuara e deshmojne qe ky arsyetim nuk qendron, per me teper ne piken tjeter AK kundershtom vetveten duke deshmuar qe ne kemi ofertuar si ne vijim:
PC HP Omen – me cpu i7-11700F respektivisht
Laptop HP Probook 440 G8 me cpu i5-1135G7.

Aludimi tjeter se : *"eshte dashte te ofertoni dhe dorezoni katalogjet te paisjeve te gjenerates se 12-te"* kjo do te qendronte sikur te kerkohej vetem paisje te gjenerates se fundit e qe kerkesa nga AK ka qene per gjeneraten e parafundit edhe ne kete pike disa rreshta me poshte AK na jep te drejt duke pohuar qe gjenerata e 12 e procesoreve eshte gjenerata e fundit.

Prandaj eshte krejtesisht e paqarte pse Autoriteti Kontraktues i referohet Aritech Shpk qe ka dorezuar oferte qe nuk ploteson specifikimin teknik kur per secilen pike vet AK ka deshmuar te kunderten.

Ndersa lidhur me vendimin e Autoritetit kontraktues perkatesisht Refuzimin e kerkeses per Rishqyrtim apo referimit te gjenerates se 13-te te procesoreve, te cilat kane dal ne treg me date 20.10.2022, perderisa ftesa per oferte ka qene me date 02.11.2022, ne e kundershtojme ne kuptim te asaj qe AK nuk ka kerkuar te bleje procesor por PC, Laptop etj.

Per te vertetuar ate qe ne themi, ne kemi kerkuar sqarime nga Distributori ITD Prishtinë shpk, distributor i shume brendeve te PC-ve dhe Laptopeve respektivisht DELL , HP , Lenovo lidhur me gjeneraten e fundit te procesoreve.

Pergjigja e tyre eshte qe nuk ka Procesor te gjenerates se 13-te as nga prodhuesit, poashtu edhe nga Intel per PC – Office, business, Home si dhe per Laptop, AIO etj.
Ne vijim mund te gjeni sqarimin printscreen nga Distributori:

From: Sherif Godeni <shgodeni@itd-ks.com>
Sent: Tuesday, December 6, 2022 3:23 PM
To: Behar Gerguri
Subject: Per MBP

Deklarat nga Distributori

Drejtuar: Aritech Shpk
Subjekt kerkese per sqarim per projekton me nr reference: UA/2016-19-9628-1-1-1

Deklarojm si ne vijim:

ITD Shpk eshte perfaqesues zyrtar brendeve Dell, Lenovo, HP etj, per Shqiper, Kosove dhe Maqedoni

Me date 02.11.2022 qe perkon me diten per njoftim e projektit si me siper asnje nje nga prodhuesit e PC-ve te cilet Ne perfaqesojme nuk ka pasur ne prodhim Kompjuter me CPU te gjenerates se 13.

Dates qe I referohemi duke perfshire edhe daten e sotme asnjeri nga prodhuesit qe perfaqesojm dhe as vet Intel (prodhuesi I procesoreve) nuk ka pas dhe nuk ka CPU te gjenerates 13 te cilet instalohet per PC -Office, Business , Home, PC- AIO , Laptop etj

Nga infot qe kemi marr nga prodhuesit qe ne perfaqesojm, Intel para disa dite ka lansuar disa CPU prototipe per kategorine PC-Gaming (ix-13xxxKF) si inovacion per disa kategori te produkteve Hi-Tec

Po ashtu jemi informuar qe Intel ende nuk ka lansuar asnje CPU te gjenerates 13 per produktet e katogorive PC Home Use, Buissness, Office, apo per ndonje model cfaredoqofte te NB apo PC-AIO.

Sherif Godeni
Head of Consumer & SM

ITD Prishtinë Shpk
Rr. Prishtinë – Lipjani,
Fshati Livaxhe, Përballë QMI
Kosovë
Tel: +381 38 606 000 ext: 120
Mob: +383 44 744 409
e-mail: shgodeni@itd-ks.com
Web: www.itd-ks.com

Confidentiality note: This e-mail and any files transmitted with it are confidential and intended solely for the use of the individual or entity to whom they are addressed. If you have received this e-mail in error please notify the sender immediately and delete this message from your computer without any further action. Any distribution or copying of this message or any files transmitted with it by an unauthorized recipient is strictly prohibited.

Prandaj nuk ka kuptim qe te thuhet qe gjenerata e 13-te, te mund te konsiderohet si gjenerate e fundit, sepse plasimi i nje lloji te procesorit (ne kete rast te Gjenerates se 13-te) perderisa nuk mund te blihet produkti sipas kerkeses ne dosje te tenderit dhe te llogaritet si gjenerate e fundit eshte nonsens, sepse edhe vet Prodhuesit e PC-ve, laptopave nuk mund te vendosin procesor te Gjenerates se 13-te ne produktet e tyre standarde sepse nuk jane prodhuar ende nga Intel.

Promovimi i nje apo dy prototipeve si inovacion nuk nenkupton last generation!

Prandaj data e promovimit te nje modeli te prototipit te cpu-ve gaming nuk nenkupton qe Intel ka plasuar ne shitje te njejtit CPU rrjedhimisht nuk mund te konsiderohet si last generation edhe po te ishte data e publikimit dhe plasimit ne treg dita e njejte!

Ashtu siç e kemi potencuar asnjeri nga prodhuesit e PC-ve (HP, Lenovo, Dell, Acer,. . .) ende nuk kane ndertuar arkitekture te PC-ve Home, Office, Business dhe te ngajshme.

(Gjendja eshte e njejte edhe diten e sotshme, pra Intel nuk ka ndonje promovim)

Per me teper kemi inkurajuar AK-ne qe te hulumtoj nese do gjej ndonje laptop nga cilido prodhues me cpu te gen 13-te, po ashtu nese do mund te gjej PC – Business , Office , Home Use , me cpu te gjenerates se 13-te.
Megjithe kerkesen tone per AK qe te na deshmoj lidhur me PC– Business , Office , Home Use , me cpu te gjenerates se 13-te, ata nuk merren me kete, **sepse qasja nga AK eshte sikur ftesa te ishte te blihet vetem Procesor te gjenerates se parafundit e jo PC-Laptop !!!**

Lidhur me gjeneraten e procesoreve ne vijim mund te shihni pergjigjen nga prodhuesi Lenovo :

Statement

We, Lenovo Technology B.V., subsidiary Ljubljana, Pot za Brdom 100, 1000 Ljubljana, Slovenia, confirm that Lenovo does not have available products with 13th generation of Intel processors yet. Vendors such as Lenovo always require rigorous testing of new parts to ensure the highest quality of production, hence we are not implementing the usage of newest generation immediately when it is announced by Intel.

Generally we introduce new Lenovo products with newest generation of processors a couple of months after the initial announcement by Intel.
Lenovo is planning to introduce the new Intel generation of processors Q2 2023.

Ljubljana, 8.12.2022

Deklarata e prodhuesit Lenovo eshte shume e qarte.
Prodhuesi Lenovo pas shpalljes nga Intel te procesoreve te gjenerates se re ben teste rigoroze te pjeseve te reja per tu siguruar rreth kualitetit te produkteve.
Poashtu konfirmon qe ende nuk ka produkte (PC, Laptop) te gjenerates se 13-te te procesoreve ne dispozicion.

Planifikimi nga lenovo eshte qe gjenerata e re e procesoreve te paraqitet ne Q2 2023. Prandaj ne e kundeshtojme qasjen e AK-se lidhur me pretendimin e tyre te padrejte rreth gjenerates se parafundit (Procesoreve) te PC-ve dhe Laptopave e cila sipas tyre eshte gjenerata e 12-te.
Bashkangjitur e gjeni deklaraten e prodhuesit Lenovo.

Po e potencojme qe kerkesa nuk ka qene te blihet vetem procesor por kerkesa eshte te blihet PC, Laptop, AIO.

Ne habitemi sesi AK- Ministria e Punëve të Brendshme i referohet promovimit te CPU nga Intel (gjenerata e 13-te) te dates 20.10.2022, ndersa ftesa per ofertim dergohet pas 12 diteve perkatesisht me date 02.11.2022, e njejta te llogaritet si Gjenerate e fundit perderisa eshte promovim/ prototip te CPU-ve per Gaming te gjenerates se 13-te nga Intel.

Per me teper ju bejme me dije qe asnje Autoritet tjeter kontraktues nuk i eshte qasur gjenerates se procesoreve ne kete menyre.

A do te thote kjo qe te gjitha Autoritetet tjera kontraktuese paskan bere shkelje lidhur me gjeneraten e procesoreve, perkatesisht jane furnizuar dhe furnizohen me produkte te gjenerates se 11-te, pasiqe qe vetem Autoriteti Kontraktues- Ministria e Punëve të Brendshme e konsideron gjeneraten e 13-te si gjenerate te fundit !!!

Ju veme ne dijeni qe ”skenar” te tille Autoriteti Kontraktues ka perdorur edhe vitin e kaluar duke aluduar ne gjeneraten e fundit te CPU-ve vetem 4 dite pas promovimit te cpu-ve (promovimi me 04 nentor 2021, kurse ftesa per ofertim 08 nentor 2021)

Qasja e tille perveç padrejtesise qe i behet Aritech Shpk si OE njekohesisht demton buxhetin e shtetit per mijera euro duke shpallur fitues OE me te shtrenjte.
Demtimi i buxhetit te shtetit shkel Nenin 6 te LPP-se.

Aritech Shpk ne oferte ka perfshire produkte Elitare nga HP (jo modele Home Use sic ka ofertuar OE qe eshte menduar te shperblehet me kontrate):

PC HP Omen me kartel te dedikuar
Laptop Probook 440 G8
PC HP Pavilion

Operatoret ekonomik mund te ofertojne me produkte te gjenerates se parafundit (Gjenerata 11) por mund te ofertojne poashtu edhe me produkte te cilat perfshijne gjeneraten e fundit te procesoreve (gjenerata e 12-te).

Ne kete rast edhe sipas Distributorit edhe sipas Prodhuesit gjenerata e 13-te nuk mund te konsiderohet e fundit.

Ne baze te argumenteve me lart shihet qarte qe komisioni i Vleresimit prane AK-se nuk ka bere vleresimin ne menyre te drejte, per cka thirren sipas rregullores dhe LPP-se.

Kerkesa ne dosje te tenderit eshte per produktin i cili perfshin ne vete procesor te gjenerates se parafundit, e cila eshte ne perdorim per PC, laptop dhe produkte tjera. Referenca per vetem procesor perkatesisht gjenerate te fundit, e cila mund te dal prej prodhimit por deri te perdorimi i saj kerkon kohe te caktuar, e njejta te vleresohet si gjenerate e fundit ne shtetin tone dhe kjo vetem nga Ministria e Punëve të Brendshme eshte e çuditshme.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit te analizoj me kujdes lenden ne fjale sepse Vendimi per kete lende do te krijoj Precedent per te gjitha Autoritetet tjera Kontraktuese lidhur me gjeneratat e procesoreve per PC, Laptop, AIO etj, qe eshte duke u zhvilluar ne kuader te AQP-se.

Duke u bazuar ne argumentet me larte kerkojme nga Organi juaj shqyrtues qe te merr vendim si ne vijim:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "ARITECH SHPK" lidhur me tenderin "**Furnizim me pajisje te IT-se**" me nr. prokurimi **214-22-12230-5-5-8-1**

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-se nga "**Ministria e Punëve të Brendshme**", tenderi të Rikthehet ne Rivleresim.
AK-së, të i kërkohet që vendimin te marr ne perputhje me kriteret e percaktuara ne dosje te tenderit, duke u bazuar ne deklaratat e Prodhuesit dhe Distributorit te produkteve per HP, Dell, Lenovo, perkatesisht kompetencen rreth percaktimit te tyre rreth gjenerates se fundit te procesoreve si dhe ne perputhje me praktikat e deritanishme nga te gjitha Autoritetet Kontraktuese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëm material direkt eshte mohimi i fitimit te caktuar, shpenzimet e përgatitjes se ankeses etj.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të*
d) *Kerkesa per Rishqyrtim*
e) *Vendimi i AK-se rreth kerkeses per Rishqyrtim*
f) *Pergjigja nga distributori ITD Prishtine shpk lidhur me gjeneraten e fundit te procesoreve*
g) *Deklarata nga prodhuesi Lenovo rreth gjenerates se 13-te te procesoreve*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*